

Hamit KABA

JUSTIFIKIMI I INTERVENIMIT TË NATO-S NË KOSOVË NË ASPEKTIN E MARRËDHËNIEVE NDËRKOMBËTARE

Abstrakt:

Artikulli merret me politikën e SHBA-së ndaj Kosovës në vitet 1998-1999, periudhë e shkurtër por me rëndësi shumë të madhe për fatin e shqiptarëve të Kosovës. Kjo çështje trajtohet në tri pjesë: përmes një hyrjeje apo begraundi historik që fokusohet në politikën amerikane ndaj Kosovës në vitet 1990-1998; tek bisedimet për planin e paqes në Konferencën e Rambujesë, të pranuar nga delegacioni i Kosovës e të refuzuar nga delegacioni serb, tek fushata ajrore e NATO-s kundër Jugosllavisë dhe miratimin e rezolutës 1244 nga Këshilli i Sigurimit, me të cilën u detyrua të pajtohej edhe Jugosllavia dhe ngjarjet që e pasuan atë. Në pjesën e fundit me karakter teorik, autori përpiqet t'i japë përgjigje pyetjes, se: "A ishte i legjitimuar sulmi i NATO-s mbi Jugosllavinë e mbetur?", duke sjellë aq sa lejon kufiri i një artikulli prova pro dhe kundër tij. Për shkrimin e këtij artikulli janë shfrytëzuar burime të ndryshme, të vjetra e të reja, të autorëve të huaj e shqiptarë, por studimet apo raportet që i janë paraqitur Kongresit Amerikan për këtë çështje nga viti 1999 e deri në vitin 2018, për shkak të vlerave të veçanta që bartin janë përdorur gjerësisht.

Fjalë kyçe:

Kosova, SHBA, Serbia, Republika Federative e Jugosllavisë, UÇK, Grupi i Kontaktit, Procesi i Paqes, Rezoluta 1244, NATO, presidenti Clinton.

Kosova dhe politika e SHBA-së deri në thirrjen e Konferencës së Rambujesë (Rambouillet)

Kosova ishte hallka e fundit e zinxhirit të shpërbërjes së përgjakshme të Jugosllavisë, pas ndarjes prej saj të Sllovenisë, Kroacisë, Maqedonisë (sot: Maqedonia e Veriut) dhe mijëra të vrarëve në Bosnjë-Hercegovinë. Në krizën

e Kosovës u përfshinë tri palë: Kosova, Serbia dhe bota Euro-Atlantike, “gjenerator” i së cilës ishte SHBA-ja.

Regjimi i Millosheviqit u përpoq të ruante gjendjen e mëparshme në Kosovë, të arritur në vitin 1989, pas eliminimit të autonomisë së saj dhe shpalljes së Serbisë unike. Heqjen e autonomisë së Kosovës në vitin 1989 dhe masat represive kundër saj, Millosheviqi u mundua që t’i justifikonte me “të drejtën e ushtrimit të sovranitetit” mbi këtë “pjesë të territorit jugosllav”, të njohur zyrtarisht nga Konferenca e Londrës e vitit 1913. Ndërsa, në Serbi festohej heqja e autonomisë, në Kosovë vendosej gjendja e jashtëzakonshme.

Pala më e rëndësishme ishin shqiptarët e Kosovës, të cilët kërkonin pavarësinë, pra shkëputjen nga Republika Federale e Jugosllavisë (RFJ). Për arritjen e saj ishte përdorur fillimisht strategjia e rezistencës pasive nën udhëheqjen e Ibrahim Rugovës. Periudha e viteve 1990-1997 njihet si periudha e ndërtimit të institucioneve të pavarura në Kosovë, por të panjohura nga komuniteti ndërkombëtar¹. Politika kosovare në këtë periudhë, si vë re me të drejtë Tim Judah, udhëhiqej nga disa gjykime: *së pari*, të qëndronin mënjanë dhe të shmangnin dhënien e një shansi për serbët, që të kryenin spastrimin etnik të krahinës, *së dyti*, ta mbanin, ose më mirë ta vendosnin Kosovën në një agjendë ndërkombëtare, dhe *së treti*, të ndërtonin një legjitimitet të sigurt për “Republikën e Kosovës”.²

Me daljen e parë publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës [UÇK] më 1997³ filloi një fazë e re për Kosovën: faza e rezistencës së armatosur. Strategjia e UÇK-së, e cila tashmë e kishte siguruar mbështetjen e madhe të qytetarëve të Kosovës, ishte që të siguronte edhe mbështetjen ndërkombëtare, veçanërisht atë të Perëndimit dhe SHBA-së, detyrë kjo jo e lehtë për t’u arritur. Gjatë kësaj periudhe Kosova u fut në rrugën pa kthim drejt lirisë dhe pavarësisë së saj, por sigurisht me koston e lartë njerëzore të bijve të saj më të mirë, me spastrimin etnik masiv, me vrasje, djegie e përdhunimeve, duke arritur përmasa të tilla që zgjuan interesin e opinionit ndërkombëtar, veçanërisht të Perëndimit e SHBA-së. Kosova u shndërrua në një problem

¹ Sabit Syla, *Arsimi shqip në Mitrovicë, 1990-1999 (Mësimdhënës dhe luftëtarë të lirisë)*, Prishtinë: Libri shkollor, 2013, f. 175-177.

² Tim Judah, *Kosovo, War and Revenge*, second edition, U.S.: Yale University Press, 2002, f. 74.

³ Sabit Syla, *Arsimi shqip në Mitrovicë...*, f. 177; Për daljen publike të UÇK-së ka edhe versione të tjera. David L. Philips ka shkruar se UÇK-ja e ka bërë paraqitjen e saj të parë publike në nëntor 1996, shih: David L. Philips, *Çlirimi i Kosovës, Diplomacia këmbëngulëse dhe ndërhyrja e SHBA-së*, Tetovë: 2015, f. 133; Në të njëjtin vit e vendos edhe Steven Woehrel, “Kosovo: Historical Background to the Current Conflict”, CRC Report for Congress, <http://www.loc.gov/crs/kosovo.html>;

mbarëkombëtar dhe ndërkombëtar. Ajo u vendos në fokusin e vëmendjes botërore si asnjëherë tjetër në historinë moderne të shqiptarëve.

Përjasja e Perëndimit dhe e SHBA-së ndaj çështjes shqiptare të Kosovës pati evolucionin e vet, të përcaktuar nga zhvillimet në Kosovë, në Serbi dhe jashtë tyre. Jugosllavia gjatë Luftës së Ftohtë kishte qenë një vend i paangazhuar, që ruajti asnjësinë ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit dhe ishte e vlerësuar prej tyre.⁴ Por, sidoqoftë nacionalizmi gjatë periudhës së komunizmit ishte aty, i fshehur dhe i presuar. Ai do ta shfaqte forcën e tij pas rivendosjes së pluralizmit politik në fillim të viteve '90-të dhe do të çonte në shpërbërjen e shtetit federativ jugosllav. Për sa kohë Tito ishte gjallë, pushteti qendror jugosllav arriti t'i mbante me sukses nën kontroll forcat nacionaliste. Me vdekjen e udhëheqësit jugosllav, nacionalizmi gërreu me shumë shpejtësi strukturën federative. Millosheviqi e shfrytëzoi problemin e Kosovës si pedanë për të marrë pushtetin, ndërsa rënia e regjimeve komuniste dhe fundi i Luftës së Ftohtë çuan në shembjen përfundimtare të Jugosllavisë dhe në shpërbërjen e saj. Si politika e SHBA-së, ashtu edhe ajo e vendeve anëtare të Tregut të Përbashkët Evropian e kishin të vështirë që të praninin shpërbërjen e Jugosllavisë, jo thjesht për shkak të shkuarës së atij shteti, por ca më shumë për shkak të së ardhmes së paqartë të vendeve të ndara prej saj dhe problemeve të brendshme të vet Evropës. Marrëveshja e Paqes e Dejtonit e vitit 1995 i dha fund luftës në Bosnjë, por nuk u mor me problemin e Kosovës, ndërkohë që tensionet shqiptaro-serbe po dilnin nga faza latente.⁵

Kujdesi dhe mbështetja e politikanëve amerikanë për Kosovën, kryesisht brenda kuadrit të të drejtave të njeriut, kishte një të shkuar pozitive. Kongresmenë, ish-kongresmenë dhe senatorë të dy partive, si Joseph J. DioGuardi, i cili i përkiste gjeneratës së parë të emigrantëve me prejardhje arbëreshe të ardhur nga Italia e Jugut, senatorët Bob Dole, Tom Lantos, Biden, Lieberman, McConnell, McCain, Eliot Engel, William Broomfield etj., nxitën Kongresin dhe qeverinë amerikane që të përfshiheshin më shumë në zgjidhjen e çështjes së Kosovës.⁶ Në ndërgjegjësimin e botës perëndimore për gjendjen në Kosovë pati ndikim të veçantë lobi shqiptar në SHBA dhe sidomos Këshilli Kombëtar Shqiptaro-Amerikan i krijuar në vitin 1996, shqiptarë të njohur të Amerikës etj. Në mars 1998 Senati i SHBA-së miratoi

⁴ Joze Pirjevec, *Tito dhe shokët*, përktheu Shpresa Rupar, Tiranë: Botart, 2020.

⁵ David L. Philips, *Çlirimi i Kosovës, Diplomacia këmbëngulëse dhe ndërhyrja e SHBA-ve*, Tetovë: 2015, f. 102-108.

⁶ Samet Dalipi, "USA and Kosovo: from human rights to independence", *Thesis no. 1*, 2013, AAB University, Pristina: 2013, f. 36; Ekrem Bardha, *E vërteta: Pavarësia e Kosovës, Amerika dhe Diaspora*, kujtime, Tiranë: UETPRESS, 2022, f. 305-307.

një rezolutë që i ngriu pasuritë e Serbisë dhe të Malit të Zi në këtë vend, ndërsa një grup prej 36 kongresmenësh i dërgoi një letër presidentit Clinton, duke i kërkuar atij që NATO të përgatitej për ndërhyrje të armatosur në Kosovë.⁷

Por angazhimi politik dhe ushtarak i Shteteve të Bashkuara dhe i vendeve të NATO-s në Kosovë, vitet 1998-1999, përfaqësonte shkallën më të lartë të tij. Pjesëmarrja e SHBA-së në një vend që së pari i përkiste Evropës dhe sidomos në një aksion të armatosur kundër Jugosllavisë së mbetur ishte e diskutueshme. Disa zëra kritikë në Kongres flisnin për situatën në Kosovë, si një pjesë e botës që nuk ndikonte mbi interesat vitale të SHBA-së. Angazhimi amerikan sipas tyre, mund të dëmtonte kredibilitetin dhe marrëdhëniet me vendet e tjera të NATO-s. Një pjesë e politikanëve në SHBA mendonin para se gjithash, se përballja me problemin e Kosovës ishte detyrim për Evropën e pastaj për Amerikën.⁸ Por ithtarët e angazhimit amerikan në Kosovë mendonin se SHBA-ja nuk mund ta harronte të shkuarën uilsoniane të këtij vendi dhe ca më shumë gjeopolitikën aktuale. Destabiliteti i Kosovës mund të ndikonte negativisht mbi stabilitetin e Ballkanit dhe të gjithë Evropës. Për zgjidhjen e krizës në Kosovë më 8 tetor 1998 u krijua Grupi i Kontaktit, të cilët përfaqësonin SHBA-në, Britaninë e Madhe, Francën, Rusinë, Gjermaninë dhe Italinë. Çështja e Kosovës në fillimin e krizës ishte një problem që duhej zgjidhur me mjete diplomatike (*shuttle diplomaci*),⁹ pa përdorur forcën. Përmes mjeteve paqësore Kosovës do t'i rikthehej autonomia e anuluar nga Millosheviqi në vitin 1989.

Dalja e UÇK-s dhe lufta e saj e armatosur kundër regjimit të Millosheviqit e ktheu vëmendjen e botës perëndimore drejt Kosovës. Tim Judah e radhit UÇK-në me organizatat ushtarake më të suksesshme në histori. “Ajo doli, siç shprehet me të drejtë ai, në vendin dhe në kohën e duhur”.¹⁰ Politika amerikane në këtë fazë nuk ishte e gatshme që të merrte në konsideratë objektivat e UÇK-së. SHBA-ja ishte e fokusuar në menaxhimin e ndryshimeve që ndodhën pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, gjë që ndikonte jo pak në vëmendjen e pakët që i kushtoi fillimisht çështjes së shqiptarëve në Kosovë. Mbi të gjitha, në kushtet e konfliktit të dhunshëm që shpërtheu në

⁷ <http://www.newamericancentury.org/kosovomilosevicsep98.html>, aksesuar më 14 tetor 2012.

⁸ CRS Issue Brief for Congress, Steven Woehrel and Julie Kim, Foreign Affairs, Defense, and Trade Division, “Kosovo and U.S. Policy”, Updated June 22, 2001, Order Code IB98041

⁹ Negociata të zhvilluara ndërmjet dy ose më shumë palëve përmes ndërmjetësive, sepse palët në konflikt refuzojnë të zhvillojnë bisedime direkte.

¹⁰ Tim Judah, *Kosovo: What Everyone Needs to Know*, New York: Oxford University Press, 2008, f. 75.

ish-Jugosllavi, qëllimi kryesor i diplomacisë amerikane ishte të mos lejonte përhapjen e luftës. Ajo ishte ndërtuar mbi supozimin se agjenda e UÇK-së për pavarësi kombëtare ishte e papranueshme, ndërsa shtypja serbe ndaj popullit shqiptar disproporcionale. Si rrjedhojë, vazhdohej të mbështetej alternativa e rikthimit të autonomisë së Kosovës, ndërsa UÇK-ja konsiderohej një forcë e dhunshme. “Ne, shkruan, ish-Sekretarja amerikane e shtetit, Madeleine Albright, në kujtimet e veta - dënuam dhunën e secilës palë”.¹¹ Në Beograd, gjatë një konference shtypi më 23 shkurt 1998, Robert Gelbard, përfaqësuesi special amerikan i presidentit dhe i Sekretarit të Shtetit për zbatimin e Marrëveshjes së Paqes së Dejtonit, i quajti ushtarët e UÇK-së “terroriste”, deklarata e përsëritur prej tij pak ditë më pas, në takimin që ai pati me Këshillin Kombëtar Shqiptaro-Amerikan (National Albanian-American Council - NAAC) në Departamentin e Shtetit.¹² Departamenti Amerikan i Shtetit u zu në befasi nga komentet e Gelbardit, sepse politika zyrtare amerikane nuk e kishte cilësuar zyrtarisht UÇK-në me këtë emërtim.¹³

Politika amerikane do të ndryshonte gradualisht pas masakrave, dhunimit dhe spastrimit etnik të ndërmarrë nga forcat paraushtarake e ushtarake të Jugosllavisë në Kosovë dhe vendosmërisë së UÇK-së për të mos u tërhequr. Masakrat e ndodhura në Kosovë në vitet 1998-1999 dhe veçanërisht ato që ndodhën në Prekaz më 5 mars 1998 dhe në Reçak më 15 janar 1999, do të çonin në reagimin e fortë të institucioneve amerikane.

Sekretarja e Departamentit të Shtetit, Madeleine Albright, në tetor 1998, emëroi Richard Holbrooke si të dërguarin e posaçëm të qeverisë amerikane në Kosovë. I dërguar amerikan ndërmori disa udhëtime për të takuar presidentin Millosheviq në Beograd, duke shërbyer si ndërmjetës për zgjidhjen e krizës së Kosovës brenda kornizës së rikthimit të autonomisë së saj të mohuar të vitit 1989. Më 5 tetor 1998 Richard Holbrooke e paralajmëroi presidentin serb, se rreziku i sulmeve të NATO-s mbi Jugosllavinë ishte i pashmangshëm nëse nuk zbatonte rezolutat e Kombeve të Bashkuara.¹⁴ Ai i

¹¹ Madeleine Albright, *Milosevic is the Problem, in A Memoir: Madam Secretary*, New York: Harper Collins, 2013, f. 388.

¹² David L. Phillips, *Çlirimi i Kosovës, Diplomacia këmbëngulëse dhe ndërhyrja e SHBA-së*, Tetovë: 2015, f. 141; Ekrem Bardha, *E vërteta: Pavarësia e Kosovës, Amerika dhe Diaspora*, kujtime, Tiranë: UETPRESS, 2022, f. 327-329.

¹³ David L. Phillips, *Çlirimi i Kosovës, Diplomacia këmbëngulëse dhe ndërhyrja e SHBA-së*, Tetovë: 2015, f. 142; David L. Phillips, *Liberating Kosovo Coercive Diplomacy and U.S Intervention* (Cambridge: The Massachusetts, Institute of Technology Press, 2012), f. 75.

¹⁴ CRC Report for Congress, Congressional Research Service, “Kosovo Conflict Chronology: September 1998-March 1999”, Congressional Research Service, Library of Congress, April 6, 1999, f. 2, RL3012.

kërkoj presidentit të Jugosllavisë me ngulm që të ndërpriste aktet e dhunës ndaj popullsisë civile në Kosovë dhe të tërhiqte trupat ushtarake serbe nga Kosova. Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara miratoi tri rezoluta të posaçme për Kosovën [rezolutat nr. 1160, 1199 dhe 1203],¹⁵ por regjimi serb i Millosheviqit nuk i zbatoi ato. Rëndësi të veçantë paraqiste rezoluta 1199 (miratuar më 23 shtator 1998), e cila kërkonte nga të dyja palët që të ndërprisnin menjëherë armiqësitë dhe të vendosnin armëpushimin me qëllim që të ndërmerreshin hapa për të përmirësuar situatën humanitare, me qëllim që të ndalonin menjëherë rritjen e dhunës në Kosovë.¹⁶

Për arritjen e këtij objekti si shqiptarët edhe serbët duhej që të fillonin menjëherë dialogun për të arritur një zgjidhje politike.¹⁷ Por asnjëra prej rezolutave të miratuara nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara nuk pati rezultat, pavarësisht premtimeve të Millosheviqit dhënë Holbrooke, dhe përpalljes së Republikës Federale të Jugosllavisë [RFJ] me sulmet e NATO-s. Më 7 tetor Presidenti Clinton urdhëroi përfaqësuesin amerikan në NATO që të votonte në favor të sulmeve ajrore mbi Jugosllavinë, nëse ajo nuk respektonte kërkesat e Kombeve të Bashkuara.¹⁸ Më 13 tetor NATO lëshoi ‘urdhër aktivizimin’, i cili i hapte rrugë sulmeve mbi Jugosllavi, nëse Millosheviqi nuk tërhiqte trupat e sigurisë nga Kosova.

Republika Federative e Jugosllavisë dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë [Organization for Security and Cooperation in Europe - OSCE] më 16 tetor firmosën një marrëveshje për vendosjen në Kosovë të një misioni, të drejtuar nga diplomati amerikan William Walker. Pas këtij akti rreth 200 vëzhgues të OSCE u vendosën në Kosovë. Ideja e një sulmi ajror të NATO-s mbi Jugosllavinë po fitonte terren, pas refuzimit këmbëngulës të udhëheqjes jugosllave për të zbatuar tre rezolutat e lartpërmendura. Duhet përmendur se politika evropiane u tregua më e druajtur

¹⁵ Më 23 shtator 1998 Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara miratoi rezolutën nr. 1199 me 14 vota pro dhe një abstenim (Kina); më 24 tetor 1998 miratoi rezolutën nr. 1203 me 13 vota, ndërsa Rusia dhe Kina abstenuan:

¹⁶ Wesley K. Clark, *Waging Modern War: Bosnia, Kosovo and the Future of the Combat*, New York: Public Affairs books, 2001, f.6-7; CRS Report for Congress, “Kosovo Conflict Chronology: September 1998-March 1999”, April 6, 1999, f. 2. <https://www.google.com/search>, 27 March 2019.

¹⁷ CRS (Congressional Research Service) Report for Congress, “Kosovo Conflict Chronology: September 1988-March 1999”, April 1999, Rezoluta përmbante 4 kërkesa për Beogradin: të ndërpriste sjelljet armiqësore ndaj popullsisë civile, të tërhiqte forcat e sigurisë nga Kosova, të lehtësonte kthimin e refugjatëve në shtëpitë e tyre dhe të arrihej progres në bisedimet me partitë shqiptare.

¹⁸ CRC Report for Congress, “Kosovo Conflict Chronology: September 1998-March 1999”, Congressional Research Service, Library of Congress, April 6, 1999, RL30127.

dhe më e rezervuar, se sa politika e SHBA-së, në lidhje me ndërmarrjen e një sulmi ajror të NATO-s mbi Jugosllavinë. Kjo qasje lidhë historinë e vet Evropës, me kohezionin e brendshëm dhe brishtësinë e saj.¹⁹

Ambasadori amerikan në Maqedoni (sot: Maqedonia e Veriut), Christopher Hill, në emër të qeverisë amerikane paraqiti një plan për autonominë e përkohshme të Kosovës, i cili u refuzua nga presidenti i Jugosllavisë, nga udhëheqësit shqiptarë dhe nga përfaqësuesit e minoritetit serb në Kosovë. Plani i paraqitur do të materializonte marrëveshjen Millosheviq-Holbrooke, të arritur në mesit e muajit tetor 1998, e cila parashikonte si afat për pranimin e konceptit të autonomisë datën 2 nëntor të këtij viti.²⁰ Për arritjen e marrëveshjes ishin bërë përpjekje që të silleshin në tryezën e bisedimeve përfaqësues të qeverisë serbe dhe të shqiptarëve të Kosovës. Më 18 tetor 1998 mbërriti në Prishtinë një delegacion serb i udhëhequr nga presidenti Milan Milutinoviq, i cili synonte të zhvillonte bisedime me udhëheqësit kryesorë shqiptarë të Kosovës. Por këta të fundit i refuzuan bisedimet, duke i konsideruar ato dredhi të Beogradit.

Sidoqoftë, “shuttle diplomaci” nuk ishte konsumuar plotësisht. Bisedimet u zhvilluan më tej në Beograd, përmes takimeve të të dërguarit amerikan, Christopher Hill, të përfaqësuesit të Bashkimit Evropian, Wolfgang Petritsch, ambasadorit austriak në Beograd dhe përfaqësuesëve të qeverisë serbe. Por kjo e fundit e refuzoi planin e përbashkët të qeverisë amerikane dhe të qeverive evropiano-perëndimore, duke paraqitur nga ana e vet një kundërpropozim, i cili ishte i papranueshëm, sepse përjashtonte nga bisedimet shqiptarët e Kosovës, ndërkohë që bënte pjesë të tyre minoritetin serb të saj. Propozimi i qeverisë serbe ishte joserioz e madje diskriminues për popullin shqiptar të Kosovës. Në këto rrethana, zëdhënësi i Departamentit të Shtetit, Jamie Rubin, e quajti presidentin Millosheviq, ‘jo thjeshtë pjesë të problemit’, por ‘vetë problemi’, duke i ngarkuar atij përgjegjësinë e të gjitha krizave jugosllave të viteve të fundit, duke përfshirë edhe krizën në Kosovë.²¹ Më 3 dhjetor 1998 ambasadori Hill i paraqiti njëkohësisht presidentit serb Milutinoviq dhe udhëheqësve shqiptarë të Kosovës një plan tjetër të rishikuar për autonominë e Kosovës. Por ai u refuzua sërish nga të dyja palët. Pas kësaj

¹⁹ Visar Xhambazi, *The Kosovo Moment: The United States and the Post-Cold War Balkans*, Master of Arts, International Studies, Old Dominion University, May 2018.

²⁰ CRS (Congressional Research Service) Report for Congress, “Kosovo Conflict Chronology: September 1988-March 1999”, April 6, 1999, f. 5.
<https://www.google.com/search>, 27 March 2019.

²¹ CRS (Congressional Research Service) Report for Congress, “Kosovo Conflict Chronology: September 1988-March 1999”, April 6, 1999, f. 5.
<https://www.google.com/search>, 27 March 2019.

ndërmarrjeje të dështuar, Hill shpalli se do të hiqte dorë nga “shuttle diplomacy”, dhe nga roli i negociatorit ndërmjet të dy palëve.

Të pafrytshme ishin edhe përpjekjet e ambasadorit amerikan në OSCE, William Walker, me Millosheviqin për të ndalur dhunën. Denoncimi prej tij i masakrës së Reçakut të datës 15 janar 1999, në të cilën u vranë në mënyrë barbare 45 shqiptarë të pafajshëm, u shoqërua me tensione të ashpra me qeverinë serbe, e cila nuk e pranoi autorësinë e kësaj vepre barbare. Ndërmjet të vrarëve kishte gra dhe fëmijë. Ambasadori Walker e bëri të qartë fajësinë e Jugosllavisë, ndërkohë që regjimi serb u përpoq ta mohonte atë. Gazeta amerikane *Washington Post* raportonte se shërbimi perëndimor i inteligjencës kishte zbuluar komunikimin ndërmjet politikanëve dhe ushtarakëve të lartë serbë, të cilët autorizuan kryerjen e masakrës së Reçakut. Pas denoncimit të ambasadorit të kryer nga ambasadori Walker, qeveria serbe në shenjë hakmarrjeje e shpalli atë preson *non grata* dhe kërkoi largimin e tij nga ‘territori serb’ për 48 orë. Por urdhri i saj nuk gjeti zbatim, pasi ambasadori amerikan i OSBE nuk u largua nga Kosova. Masakra e Reçakut bëri “xhiron e botës” dhe zgjoi interesin e opinionit ndërkombëtar për Kosovën, ndërsa ambasadorët e NATO-s mbajtën një takim emergjence për këtë ngjarje të rëndë. Autoritetet ushtarake jugosllave e ndaluan prokurorin e Krimeve të Luftës të Kombeve të Bashkuara, Louise Arbour, që të hynte në Kosovë dhe të hetonte për krimet e kryera në Reçak. Më 19 janar Këshilli i Sigurimit i OKB paraqiti një deklaratë mbi Kosovën, pas sesionit emergjent të thirrur me kërkesën e Shqipërisë. Deklarata dënonte masakrën e Reçakut dhe kritikonte refuzimin e Beogradit për të pranuar hyrjen e prokurorit të OKB-së në Kosovë.

Më 26 janar 1998 zyrtarët e SHBA-së e lanë të hapur mundësinë e dërgimit të trupave amerikane në Kosovë si pjesë e trupave paqeruajtëse, por ende nuk ishte marrë ndonjë vendim për këtë qëllim. Presidenti Clinton autorizoi dhënien e 25 milionë \$ ndihma për Kosovën, të cilat do të përdroreshin për refugjatët, personat e shpërngulur dhe viktimat e luftës. Administrata e Clintonit deklaronte se SHBA-ja po ndiqte njëkohësisht dy pista për Kosovën, njëra për zhvillimin e menjëhershme të negociatave, ndërsa tjetra për ndërmarrjen e sulmit ushtarak përmes NATO-s. Pra, ashtu si pranonte edhe Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Kofi Annan, do të “kombinoheshin forca me diplomacinë, si mjet kyç për arritjen e paqes në Ballkan”²². Më 30 janar 1999 Këshilli i Atlantikut të Veriut (North Atlantic

²² CRS (Congressional Research Service) Report for Congress, “Kosovo Conflict Chronology: September 1988-March 1999”, April 6, 1999, f. 9.
<https://www.google.com/search>, 27 March 2019.

Council-NAC) aprovoi urdhrin për sulmet ajrore të NATO-s kundër Serbisë, nëse udhëheqësit e këtij vendi do të vazhdonin të refuzonin negociatat me palën kosovare.²³

Qëndrimi i SHBA-së në Konferencën e Rambujesë

Në rrethanat kur *Shuttle Diplomacy* nuk po jepte rezultat, ndërsa gjendja dhe spastrimi etnik në Kosovë po merrte përmasa të mëdha, Grupi i Kontaktit vendosi të thërriste Konferencën e Rambujesë dhe të diskutonin mbi plan-projektin e paqes për Kosovën.²⁴ Më 29 janar 1999 ministrat e Jashtëm të Grupit të Kontaktit u bënë ftesë përfaqësuesve të Serbisë/RFJ dhe të partive politike të Kosovës, që të merrnin pjesë në negociatat për paqen që do të mbaheshin në këtë vend, më 6 shkurt 1999. Grupi i Kontaktit parashikonte që punimet të zgjasnin rreth 6 ditë, duke paraparë mundësinë e zgjatjes së tyre edhe një javë tjetër. Ndërkohë, ai i kërkoi Jugosllavisë që të ndalonte veprimet ofensive ushtarake në Kosovë, të zbatonte rezolutat e Këshillit të Sigurimit dhe të bashkëpunonte me OSBE-në dhe Gjykatën e Krimeve të Luftës. Nga UÇK-ja u kërkua që të ndalonte provokacionet ndaj forcave serbe dhe të zbatonte rezolutat e lartpërmendura.²⁵ Më 2 shkurt 1999, krerët e UÇK-s, përveç Adem Demaçit, pranuan të merrnin pjesë në bisedimet e sponsorizuara nga Grupi i Kontaktit. Më 19 shkurt, Hashim Thaçi drejtues politik i UÇK-së u takua me Adem Demaçin, zëdhënësin politik të kësaj organizate, i cili refuzonte të merrte pjesë në bisedimet e Rambujesë. Demaçi thuhet se i kërkoi Thaçit që të ndiqte qëndrimin e linjës së fortë në Konferencë.²⁶ Konferenca u hap më 6 shkurt nga presidenti francez, Jacques Chirac, ndërsa bashkëkryetarë të saj ishin Hubert Vedrine - ministër i Jashtëm i Francës dhe Robin Cook - sekretar i Jashtëm i Britanisë së Madhe. Qeveria jugosllave pranoi që të merrte pjesë në Konferencën e Rambujesë, por më 4 shkurt 1999, dy ditë para hapjes së saj, parlamenti serb aprovoi një deklaratë

23 Kosovo Conflict Chronology: September 1998 - March 1999, April 6, 1999 RL30127, Congressional Research Service the Library of Congress

<https://www.everycrsreport.com/reports/RL30127.html>, 1 November, 2023.

²⁴ http://www.state.gov/www/regions/eur/ksvo_rambouillet_text.html, 21 nëntor 2023.

²⁵ Kosovo Conflict Chronology: September 1998 - March 1999, April 6, 1999 RL30127, Congressional Research Service the Library of Congress

<https://www.everycrsreport.com/reports/RL30127.html>, 1 November, 2023.

²⁶ Kosovo Conflict Chronology: September 1998 - March 1999, April 6, 1999 RL30127, Congressional Research Service the Library of Congress

<https://www.everycrsreport.com/reports/RL30127.html>, 1 November, 2023

që thoshte: “nuk pranohet prezenca e ushtarëve të huaj në territorin tonë”,²⁷ me arsyetimin se ajo ishte në kundërshtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara,²⁸ ndërsa Kosova për parlamentin serb shihej thjesht si problem i brendshëm i Jugosllavisë. Pala serbe dërgoi një delegacion të përbërë nga 13 vetë dhe të kryesuar nga presidenti serb Milan Milutinović. Delegacioni kosovar kishte në përbërjen e vet 16 anëtarë, që përfaqësonin tre grupime.

Ndërkohë që Konferenca vazhdonte punimet, i dërguari amerikan Christopher Hill, udhëtoi për në Beograd për të bindur Millosheviqin që të pranonte draft-finalin e marrëveshjes, por ishte e pamundur që presidenti jugosllav të pranonte kushtin për vendosjen e trupave të NATO-s në territorin jugosllav. Gjatë gjithë kohës delegacioni serb iu përmbajt me fanatizëm deklaratës së mësipërme për të mos pranuar në territorin jugosllav vendosjen e trupave të NATO-s. Prania e trupave të huaj sipas tij dhunonte sovranitetin dhe pavarësinë e Jugosllavisë. Ndërkohë që ministri i Jashtëm i Jugosllavisë, Zividan Jovanović, përsëriste këtë tezë, zëdhënësi i DSH-së, Jamie Rubin, e paralajmëroi atë se do të ishin subjekt i bombardimeve të NATO-s, po qe se delegacioni shqiptar miratonte planin e paraqitur në Konferencë nga Grupi i Kontaktit. Tre negociatorët ndërkombëtarë: Chris Hill [SHBA], ambasadori Wolfgang Petritsch [Bashkimit Evropian] dhe ambasadori rus Boris Mayorsky, njoftuan gazetarët për mungesën e progresit në këto bisedime.

Draft-marrëveshja e paraqitur nga Grupi i Kontaktit nuk u pranua as nga delegacioni kosovar, i cili i përmbahej idesë së pavarësisë së Kosovës dhe ndarjes së saj përfundimtare nga Jugosllavia. Në mungesë të definicionit të pavarësisë së Kosovës, delegacioni shqiptar më 22 shkurt kërkoi që të shtohet fjala “referendum”.²⁹ Shtypi i huaj shkruante për delegacionin shqiptar se, anëtarët e Grupit të Kontaktit ishin të habitur dhe të papërgatitur ndaj qëndrimit të mbajtur prej tyre në Konferencë. Disa politikanë të lartë të SHBA-së bënë përpjekje që të bindnin delegacionin kosovar që ta firmoste projekt-marrëveshjen. Madlene Albright, sipas dokumenteve, i bëri të ditur delegacioni kosovar se pa miratimin e marrëveshjes nga ana e tyre, nuk do të kishte sulme të NATO-s kundër Serbisë. Disa politikanë dhe ushtarakë të lartë amerikanë u përpoqën gjithashtu që të bindnin delegacionin kosovar.

²⁷ CRS (Congressional Research Service) Report for Congress, *Kosovo Conflict Chronology: September 1988-March 1999, April 6, 1999*, p. 10.
<https://www.google.com/search>, 27 March 2019.

²⁸ *Charter of the United Nations and Statute of the International Court of Justice*, Published by the UND of Public Information, October 1997, shih: artikullin 51.

²⁹ Kosovo Conflict Chronology: September 1998 - March 1999, April 6, 1999 RL30127, Congressional Research Service the Library of Congress
<https://www.everycrsreport.com/reports/RL30127.html>, 1 November, 2023

Gjenerali Wesley Clark u takua posaçërisht me delegacionin shqiptar në një zonë ushtarake afër Rambujesë. Takime të kësaj natyre zhvilloi edhe Christopher Hill, Bob Dole etj. Përfundimisht delegacioni kosovar pranoi parimisht se do ta firmoste marrëveshjen, por kërkoi dy javë kohë për konsultime me faktorin shqiptar në Kosovë. Më 23 shkurt Grupi i Kontaktit lëshoi një deklaratë e cila theksonte se palët kishin rënë në konsensus për autonominë substanciale për Kosovën dhe se ato do të mblidheshin sërish në Rambuje më 15 mars për të diskutuar më tej. Por marrëveshja përfundimtare nuk ishte arritur ende. Mosmiratimi i draftit të paraqitur nga Grupi i Kontaktit dhe ngecja e punimeve të Konferencës së Rambujesë e ritheksoi planin e sulmit të NATO-s. Drejtori i Përgjithshëm i CIA-s, George Tenet, dëshmoi përpara Komitetit të Shërbimit të Armatosur të Senatit se, nëse nuk ndërhyhej në Kosovë, do të kishte më tepër luftime se më parë.³⁰

Presidenti Clinton dhe Sekretarja e Shtetit, Madeleine Albright, mbështetën versionin e pjesëmarrjes së trupave paqeruajtëse amerikane në Kosovë, duke argumentuar rrezikun që paraqiste përhapja e konfliktit në rajon. Ndërkohë, nënsekretari amerikan i Mbrojtjes deklaronte në Komitetin e Shërbimeve të Armatosura se kostoja e 4 000 trupave ushtarake që do të vendoseshin në Kosovë do të kushtonte 1,5-2 miliard \$ në vit. Ndërkaq rezervat e delegacionit shqiptar rreth planit të paqes për Kosovën nuk ishin shuar. Christopher Hill u takua sërish me delegacionin shqiptar më 3 mars dhe u shpreh optimist për firmosën e marrëveshjes. Ish-drejtuesi i Senatit, Bob Dole, pranoi kërkesën e Albright për t'u takuar me delegacionin shqiptar. UÇK përcaktoi Hashim Thaçin si drejtuesin e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, por Adem Demaçi refuzoi sërish të firmoste marrëveshjen e Rambujesë.

Marrëveshja e Rambujesë u firmos nga delegacioni kosovar më 18 mars 1999.³¹ Ky hap u konsiderua me të drejtë si fitore për Grupin e Kontaktit dhe veçanërisht për popullin shqiptar të Kosovës. Duhet përmendur se, delegacioni shqiptar duhej të mbante mbi shpatulla një përgjegjësi të madhe përpara popullit të vet. Firmosja e aktit të Rambujesë do t'i hapte rrugën procesit të gjatë të pavarësisë së Kosovës dhe ndreqjes së një padrejtësie gati një shekullore. Grupi i Kontaktit botoi një deklaratë për arritjen e “autonomisë substanciale” për Kosovën. Më 12 mars, ministri i Jashtëm, rus Igor Ivanov, dhe analogu i tij grek George Papandreou, patën një takim me presidentin

³⁰ Kosovo Conflict Chronology: September 1998 - March 1999, April 6, 1999 RL30127, Congressional Research Service the Library of Congress

<https://www.everycrsreport.com/reports/RL30127.html>, 1 November, 2023.

³¹ http://www.state.gov/www/regions/eur/ksvo_rambouillet_text.html, 21 nëntor 2023

Milloseviq në Beograd, me qëllim që ta bindnin atë për të firmosur Marrëveshjen e Rambujesë. Por presidenti jugosllav nuk i pranoi këshillat e tyre. Holbrooke shkoi për herë të fundit në Beograd më 22 mars që të bindte Milloseviqin për të firmosur marrëveshjen, por pas disa orë bisedimesh, sukcesi nuk u arrit. Refuzimi i delegacionit jugosllav për të firmosur marrëveshjen i ezauroi mjetet paqësore, tashmë sulmet ajrore të NATO-s mbi Jugosllavi dhe vendosja pas kësaj të trupave paqeruajtëse në Kosovë mbeteshin e vetmja rrugëzgjdhje.

Presidenti Clinton u shpreh në një konferencë shtypi se konflikti i Kosovës kërcënonte interesat kombëtare të SHBA-së, se “aksioni dhe zgjidhja do të ndalojnë ushtritë dhe do të shpëtojnë jetë njerëzish”. Më 22 mars Senati miratoi rezolutën nr. 21 me 58 vota pro dhe 41 kundër, e cila e autorizonte presidentin që të drejtonte operacionet kundër Jugosllavisë. Senati nuk e diskutoi faturën financiare që do të shpenzonte qeveria amerikane në Kosovë, e cila mund të shoqërohej me hezitime dhe kufizim fondesh. Fatura financiare paraprake e qeverisë amerikane për vendosjen e 4 000 trupave paqeruajtëse në Kosovë llogaritej tek 1,5-2 miliard dollarë në vit. Ndërkohë, kryeministri rus, Yevgeny Primakov, ndërpreu udhëtimin e tij për në Amerikë, duke u kthyer për në Moskë mbi ujërat e oqeanit Atlantik. Ditën e fillimit të sulmit, presidenti Clinton do të deklaronte: “se nëse presidenti Milloseviq nuk do të bëjë paqe, ne do t’i kufizojmë mundësitë e tij për të bërë luftë”. Vetëm tre ditë pas fillimit të sulmeve të NATO-s, Këshilli i Sigurimit do të votonte kundër projekt-rezolutës së propozuar nga Rusia, e cila synonte të ndalonte aksionet ajrore të NATO-s. Por kundër miratimit të rezolutës votuan 12 anëtarë të KS, ndërsa pro saj vetëm tre: Rusia, Kina dhe Namibia.

Më 23 mars Republika Federative e Jugosllavisë deklaroi gjendjen e vendit në situatë të jashtëzakonshme dhe thirri nën armë me mijëra rezervistë. Mali i Zi, partneri i vogël i saj, refuzoi që të pranonte këtë deklaratë. Fushata e bombardimeve 78-ditore të NATO-s përfundoi më 9 qershor 1999. NATO sulmoi objektivat ushtarake dhe sistemin e mbrojtjes ajrore me raketa ‘cruise’ dhe me bomba. 13 nga 19 vendet anëtare të NATO-s morën pjesë në operacionet ajrore kundër Jugosllavisë. Më 24 mars presidenti Klinton bëri një deklaratë të posaçme për sulmet e NATO-s, duke vënë theksin tek tri objektivat e saj: demonstrimin e kundërshtimit të NATO-s ndaj agresionit serb në Kosovë; frenimin e presidentit Milloseviq nga vazhdimi i sulmeve mbi popullsinë civile dhe së fundi, dëmtimi i kapaciteteve të tij, duke shkatërruar aftësitë ushtarake të Serbisë. Më 9 qershor u nënshkrua në Kumanovë marrëveshja tekniko-ushtarake ndërmjet NATO-s dhe oficerëve

ushtarakë jugosllavë për tërheqjen e forcave jugosllave nga Kosova.³² Vetëm një ditë më pas, më 10 qershor, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara miratoi rezolutën 1244, bazuar në planin ndërkombëtar të paqes, të pranuar edhe nga Millosheviqi. Më 11 qershor trupat e KFOR-it filluan të hynin në Kosovë. Më 20 qershor UÇK dhe NATO firmosën dokumentin për çmilitarizimin e UÇK-së.³³

Pas qershorit të vitit 1999, administrimi i Kosovës funksionoi mbi bazën e statusit të miratuar me rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Rezoluta autorizonte një prezencë ndërkombëtare ushtarake e civile në Kosovë, zgjatja e të cilës ishte nën autoritetin e Këshillit të Sigurimit. Forca paqeruajtëse e NATO-s, KFOR (The Kosovo Force),³⁴ është ngarkuar që të sigurojë një mjedis të sigurt, ndërsa Misionit të Kombeve të Bashkuara (UNMIK) do të kishte rol drejtues në administrimin e Kosovës me baza të përkohshme. Rezoluta siguronte një periudhë të përkohshme autonomie për një afat të papërcaktuar për Kosovën, derisa të fillojnë negociatat mbi të ardhmen e saj. UNMIK do të mbikëqyrte transferimin e autoritetit nga institucionet e përkohshme autonome drejt atyre të përhershme, pasi Kosovës t'i përcaktohej statusi i ardhshëm. Rezoluta 1244 nuk jepte një ide të qartë se si do të zgjidhej çështja e statusit, ajo thjesht fliste për një “proces politik” të paspecifikuar. Megjithatë, rezoluta konfirmonte qartazi integritetin territorial të Federatës Jugosllave (të përbërë nga Serbia dhe Mali i Zi) dhe bënte fjale për “autonomi substanciale” për Kosovën brenda Republikës Federative të Jugosllavisë-RFJ [e cila u shpërbë përfundimisht pas ndarjes prej saj të Malit të Zi në vitin 2006].

Rezultati final i ngjarjeve në Kosovë, në vitet 1998-1999, falë kokëfortësisë së serbëve dhe metodave barbare të përdorura nga Millosheviqi, dukej se ishte diçka tjetër nga ajo që kishin projektuar fillimisht Perëndimi dhe SHBA-ja. Përcaktimi i të ardhmes së Kosovës mbetej një çështje e hapur për t'u zgjidhur. Në artikullin I, neni 3 të Marrëveshjes së Rambujesë me titull “Amendim dhe vlerësim gjithëpërfshirës” shkruhet: “Tri vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje do të thirret një takim ndërkombëtar, për të përcaktuar mekanizmin për një zgjidhje përfundimtare të Kosovës, mbi bazat e vullnetit të popullit, opinioneve të autoriteteve përkatëse, përpjekjeve të çdo grupi në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe të Aktit Final të

³²Steven Woehrel and Julie Kim, CRC “Issue Brief for Congress”, Congressional Research Service, Library of Congress, June 2001, p. 4.

³³CRS Issue Brief for Congress, Steven Woehrel and Juli Kim, “Kosovo and U.S. Policy”, Order Code IB98041, June 22, 2001.

³⁴Trupë paqeruajtëse ndërkombëtare e udhëhequr nga NATO.

Helsinki, për të marrë përsipër një vlerësim gjithëpërfshirës për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe për të marrë në shqyrtim propozimet e çdo pale për masa plotësuese”.³⁵ Marrëveshja nuk përmbushte kërkesat e delegacionit shqiptar dhe veçanërisht të kryetarit të tij, Hashim Thaçi për pavarësinë të Kosovës dhe ndarjen e saj nga Jugosllavia e mbetur. Por sidoqoftë, ajo linte një shteg të hapur për të ardhmen e saj, në përputhje me vullnetin e popullit të Kosovës, ndonëse në të do të përfshiheshin edhe aktorë të tjerë ndërkombëtarë, duke përfshirë edhe vetë Serbinë. SHBA-ja, sikurse tregoi e ardhmja, vazhdoi të mbetet faktori kyç në arritjen e pavarësisë së Kosovës, pavarësisht se cili president do ta drejtonte Shtëpinë e Bardhë.

A ishte e legjitimuar dhe e justifikuar ndërhyrja e NATO-s në Kosovë?

Kjo çështje ende edhe sot vazhdon të mbetet e debatueshme dhe e diskutueshme ndërmjet studiuesve, politikanëve dhe opinionit publik. Ata mbeten të ndarë për problemin e legjitimitetit apo palegjitimitetin e ndërhyrjes së armatosur të NATO-s në Kosovë, pavarësisht nga vendet nga të cilët ata vinë. Shumë prej tyre i konsiderojnë bombardimet e Traktatit të Atlantikut të Veriut mbi Republikën Federative të Jugosllavisë të motivuara e të justifikuar.³⁶ Të tjerë e quajnë ndërhyrjen e forcave të NATO-s të pajustificuar, shkelje të së drejtës ndërkombëtare dhe dhunim të një vendi të pavarur.³⁷ Debati dhe qëndrimet e ndryshme kanë lindur nga fakti se forcat e

³⁵ Rambouillet Agreement for Peace and Self-Governance in Kosovo, Archive Site for State Department, <http://state.gov/www/region>, 16.07. 2001.

³⁶ Shih: Tim Judah, *Kosovo War and Revenge*, Second Edition, (U.S.: Yale University Press, 2002); Wesley K. Clark, *Waging Modern War: Bosnia, Kosovo and the Future of Combat* (New York: Public Affairs books, 2001); Ramë Buja, *Kosovo in Yugoslav Crisis*, (Prishtina: AAB-RIINVEST, 2011); VisarXhambazi, *The Kosovo Moment: The United States and the Post - Cold War Balkans*, Master of Arts, International Studies, Old Dominion University, May 2018, p. 37; Shaqir Vukaj, “Albania in the Balkan context”, in: *European Union-Russia: Balkan Situation*, (Moscow: Interdialect, 2000); Sylë Ukshini, “Roli i politikës gjermane në Konferencën e Paqes në Rambuje”, *Studime historike*, nr. 1-2, Instituti i Historisë/QSA Tiranë: 2016; Sylë Ukshini, *Kosova në politikën e jashtme të BE-së 1991-2007*, Shkup: Logosa, 2008, etj.

³⁷ Shih: David N. Gibbs, “Was Kosovo the Good War”? *Tikkun Magazine*, July 07, 2009; Daniel H. Joyner, “The Kosovo Intervention: Legal Analysis and a More Persuasive Paradigm”, *EJIL*, (2002), Vol. No.3, 597-619; Grigory B. Karasin, “Russia and the Balkan Situation”, in: *European Union-Russia: Balkan Situation*, (Moscow: Interdialect+, 2000); Nicolai P. Shmelev, “Russia and Europe on the threshold of the 21st Century”, in: *European Union-Russia: Balkan Situation*, (Moscow: Interdialect, 2000); Igor F. Maximyshev, “Crisis of Confidence: NATO’s Balkan adventure brought Europe to the threshold of a new Cold War”, in: *European Union-Russia: Balkan Situation*, (Moscow:

NATO-s për herë të parë u përfshinë në një aksion të madh ushtarak kundër një vendi tjetër, pa siguruar më parë miratimin e të gjithë vendeve anëtare të Këshillit të Përhershëm të Sigurimit.

Sigurisht do të kishte qenë më mirë që NATO të kishte siguruar më parë miratimin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, por kjo ishte e pamundur për shkak të sinjaleve të qarta kundërshtuese të dy prej anëtarëve të përhershëm të tij, Rusisë dhe Kinës, të cilat do të vendosnin veton, nëse ky version do të votohej në Këshillin e Sigurimit. Rusia dhe Kina e kundërshtuan fort metodën e ndërhyrjes së armatosur të NATO-s pa miratimin e KS, duke e quajtur veprimin e saj si shkelje të rëndë të së drejtës ndërkombëtare.

Por përpara ndërhyrjes ajrore të NATO-s ekzistonin diferenca e lëkundje në qëndrimet e vendeve anëtare të saj. Jo të gjitha vendet anëtare mendonin se rruga më e mirë ishte ndërhyrja ushtarake e forcave të saj mbi Jugosllavinë e mbetur. Vende të tilla evropiane, si Franca, Gjermania e Italia prireshin drejt rrugës diplomatike të zgjidhjes së krizës, ndërsa SHBA-ja dhe Britania e Madhe nuk e shihnin si oportune zgjatjen pa fund të dialogut me Jugosllavinë e Millosheviqit. Por refuzimi i Millosheviqit për të firmosur deklaratën e Konferencës së Rambujesë, spastrimi etnik i popullsisë shqiptare dhe shtimi i operacioneve policore në Kosovë i afrooi qëndrimet e këtyre vendeve. Opsioni i ndërhyrjes ushtarake pas kësaj kohe, u konsiderua si e vetmja mënyrë për të zgjidhur krizën dhe për të shpëtuar popullin shqiptar të Kosovës nga spastrimi etnik.

Në Gjermani, partitë në koalicion, [Partia Socialdemokrate dhe Partia e Gjelbër], ndonëse me profil pacifist, u pajtuan me versionin e ndërhyrjes së armatosur, me qëllim që të ndalonin dhunën dhe mizoritë e forcave serbe në Kosovë. Në Francë, forcat politike prireshin më shumë për një zgjidhje diplomatike se sa ushtarake. Qëndrim ekuivalent me të Francës mbante edhe Italia, ndërsa partitë e saj politike ishin të ndara në qëndrimet e tyre. Sidoqoftë, duhet theksuar se edhe qeveria italiane jo vetëm që u bashkua me aksionin e NATO-s, por mbuloi një kosto shtesë me kontributin që dha për refugjatët kosovarë në Shqipëri. Greqia, e ushqyer sidomos nga mediet antiamerikane dhe nga opinioni publik brenda vendit, e kundërshtoi fillimisht ndërhyrjen e NATO-s. Por qëndrimi i saj ndryshoi, duke pasur në konsideratë interesat e saj afatgjata. Greqia vendosi t'i bashkohej kauzës së përbashkët të vendeve të NATO-s.³⁸ Ndërmjet të gjitha shteteve mbrojtja më e fortë e versionit të ndërhyrjes ushtarake në Kosovë, erdhi nga Britania e Madhe.

Interdialect+, 2000), etj.

³⁸ Visar Xhambazi, "From Collective Defense to Collective Security: NATO Intervention in Kosovo", *Journal of Political Science & Public*, Volume 5, Issue 2, U.S.: May 2017, f. 2.

Kryeministri Toni Blair e gjykoi ndërhyrjen si një kauzë të drejtë, duke kërkuar përgjigje unike ndaj agresionit serb në Kosovë. Me këtë qëndrim u bashkuan edhe Shqipëria, Kroacia, Sllovenia e Turqia.

Natyrisht që SHBA-ja për shkak të forcës dhe autoritetit të tyre në arenën ndërkombëtare, përbënin faktorin më të rëndësishëm dhe më me peshë në Organizatën e Atlantikut të Veriut dhe në Grupin e Kontaktit. Ithtarët e angazhimit amerikan në Kosovë mbronin idenë se destabiliteti i Kosovës do të ndikonte negativisht mbi stabilitetin e Ballkanit dhe të Evropës, e cila paraqiste interesa vitale për SHBA-në.³⁹ Mungesa e stabilitetit në Ballkan do të shoqërohej me krijimin e kushteve të favorshme për krimin e organizuar, terrorizmin, dhe do të minonte qëllimet afatgjata të Amerikës për integrimin evropian dhe bashkëpunimin e vendeve të rajonit. Por rrethet kritike në të dy anët e Atlantikut mendonin se, roli i Evropës në Ballkan duhej të ishte dominues në krahasim me atë të SHBA-së, dhe se vendet evropiane duhej të udhëhiqnin përpjekjet ndërkombëtare për zgjidhjen e krizës në Kosovë.

Me gjithë kritikën e shfaqura brenda vendit nga disa rrethe të caktuara, ato nuk mundën të ndikonin mbi politikën e jashtme të qeverisë amerikane. Sekretarja amerikane e Shtetit, Madeleine Albright, u përpoq të largonte ngurrimin e vendeve perëndimore, duke sjellë në vëmendje katastrofën e ndodhur vite më parë në Bosnjë. Ajo foli për sigurimin kolektiv, si mjetin më efikas për të ndaluar përhapjen e krizave. Luftës së Kosovës i referohen shpesh edhe si “*lufta e Madelein-ës*”. Administrata e Clinton-it nxiti në mënyrë konstante “sigurinë kolektive”, për të justifikuar ndërhyrjen në Kosovë. Presidenti Clinton në disa raste i është referuar parimeve uillsoniane, si e drejta e vetëvendosjes. Gjenerali Wesley Clark, komandanti Suprem i Forcave Aleate në Evropë, në kujtimet e tij fajëson Perëndimin, sepse nuk qe në gjendje të parandalonte katastrofat e mëparshme, duke nënkuptuar sidomos ngjarjet në Bosnjë, në Ruanda etj. “Kombet e tjera, shkruante ai, shihnin tek US rolin e lidershit, dhe ne kishim nevojë të punonim ngushtë me ta, për të ndihmuar në ndarjen e barrës, e cila në të kundërt do të binte vetëm mbi ne”.⁴⁰

Shumica e shteteve mbështetën bombardimet e NATO-s mbi Serbinë. Legjitimiteti i ndërhyrjes së saj ishte logjik dhe i motivuar. Nuk mund të flitet për siguri dhe integritet të një vendi, pa respektuar të drejtat e njeriut dhe shoqërinë paqësore, siç parashikohej në Kartën e të Drejtave të Njeriut të

³⁹ “Kosovo and U.S. Policy: Background to Independence”, CRS Report for Congress, June 2008, f. 2-3.

⁴⁰ Wesley K. Clark, *Waging Modern War: Bosnia, Kosovo and the Future of Combat*, New York: Public Affairs books, 2001.

miratuar nga Kombet e Bashkuara në vitin 1948.⁴¹ Aksioni i ndërhyrjes në Kosovë u mbështet dhe u justifikua mbi dy argumente bazike të lidhura me njëri-tjetrin, tek doktrina e ndërhyrjes humanitare dhe tek zbatimi i tre rezolutave të miratuara nga Këshilli i Sigurimit për Serbinë, të cilat i kushtoheshin represionit serb në Kosovë.⁴² Në muajt mars, shtator dhe tetor 1998, Këshilli i Sigurimit kishte miratuar 3 rezoluta të posaçme për Kosovën.

Periudha e shkuar dhe ngjarjet e përgjakshme në Ballkan e kishin bërë deri-diku të qartë rolin negativ dhe fytyrën e vërtetë të Millosheviqit. Në Perëndim, para ndërmarrjes së fushatës ajrore në Serbi e Kosovë, ishin ndërgjegjësuar për rolin e Millosheviqit dhe përfshirjen e tij direkte apo indirekte në luftën me Kroacinë, dhe sidomos në përgjakjen e Bosnjë-Hercegovinës. Nuk ishin të panjohura metodat barbare të përdorura prej tij për krijimin e Serbisë së Madhe dhe ruajtjen e pushtetit personal. Ndonëse për një kohë ai u konsiderua ende si një aktor i vlefshëm në skenën ndërkombëtare, për të ekzistonin dyshime të forta si lojtar që luante “pisët” prapa skenës. “Për herë të tretë gjatë një dekade, shkruan Michael H. Armacost në parathënien e librit *Winning Ugly-NATO-s War to save Kosovo*, të autorëve Ivo H. Daalder dhe Michael E. O’Hanlon, dhuna ishte shkaktuar nga politika nacionaliste e diktatorit jetëgjatë të Serbisë, Slllobodan Millosheviqit. “Ndërsa fillimisht, shkruante autori i lartpërmendur, ai kishte mbështetur serbët surrogatë lokalë në luftërat kroate e boshnjake, dhuna ndaj Kosovës ishte e kontrolluar direkt prej tij, dhe se brenda vetë Serbisë përfshiheshin territore, të cilat kishin rëndësi të madhe historike, kulturore dhe fetare për të gjithë serbët”.⁴³ Vrasjet dhe spastrimet e shqiptarëve nga Kosova deri në këtë kohë u kryen nën përgjegjësinë direkte të Slllobodan Millosheviqit, dhe për këtë nuk kishte më dyshime. Trupat policore e paraushtarake serbe kishin nisur fushatën e spastrimeve etnike në Kosovë përpara fillimit të operacioneve ajrore të NATO-s. Sipas studiuesve Leonard J. Cohen dhe John R. Lampe, vetëm gjatë vitit 1998 nga Kosova ishin detyruar të largoheshin rreth 200 000 shqiptarë, ndërsa numri i të shpërngulurve para fillimit të sulmeve të NATO-s [24 mars 1999] arrinte në 250-300 mijë vetë.⁴⁴ Ishin vrarë me qindra luftëtarë të UÇK-së dhe ishte

⁴¹ *Charter of the United Nations and Statute of the International Court of Justice*, Published by the UND of Public Information, October 1997.

⁴² Visar Xhambazi, “From Collective Defense to Collective Security: NATO Intervention in Kosovo”, *Journal of Political Science & Public*, Volume 5, Issue 2, U.S.: May 2017, f. 2-3.

⁴³ Ivo H. Daalder and Michael E. O’Hanlon, *Winning Ugly-NATO-s War to save Kosovo*, Washington, D.C.: Brookings Institution Press, 2000, f.vii.

⁴⁴ Shih: Tim Judah, *Kosovo and Revenge*, second edition, (U.S.: Yale University Press,

ushtruar dhunë e ashpër mbi popullsinë civile. Luftimet e ashpra kundër forcave serbe në Prekaz më 5 mars 1998, dhe si pasojë vrasjet deri në asgjësim të familjes së madhe të Jasharajve dhe masakra e Reçakut më 15 janar 1999, bënë “xhiron e botës”. Ato dëshmuuan për sjelljen barbare të forcave ushtarake serbe dhe ushqyen idenë e pashmangshmërisë dhe të reagimit ushtarak të Perëndimit e SHBA-së.

Disa qeveri në Perëndim, e veçanërisht ajo gjermane, kishin të dhëna nga shërbimet e tyre të fshehta për planet sekrete serbe të spastrimeve etnike në Kosovë, të njohur me emrin e koduar “Plani Patkoi”.⁴⁵ Pra, kthimi i popullit të Kosovës në popull muhaxhir nuk ishte pasojë e bombardimeve të NATO-s, as një veprim i çastit i diktuar nga ndërhyrja e saj, por një aksion i paramenduar dhe i planifikuar nga shteti serb.

Përkundër tezave që mbrojnë dhe argumentojnë bombardimet e NATO-s mbi Serbinë, ka jo pak studiues që mendojnë e shkruajnë ndryshe. Në përgjithësi ata i bashkon ideja se ndërhyrja e forcave ushtarake të NATO-s në Kosovë e Serbi ishte e paligjshme, dhe se ajo përbënte shkelje të së drejtës ndërkombëtare. Nga ky grupim do të veçonim studimin e profesorit amerikan të historisë në Universitetin e Arizonës, David N. Gibbs, me titull: *A ishte Kosova një luftë e mirë?*⁴⁶ Gibbs përpiket të rrëzojë tezat kryesore mbështetëse që argumentojnë ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë, duke i quajtur ato mite të krijuara nga politika. *Së pari*, ai mbron idenë se vendet pjesëmarrëse në Konferencën e Rambujesë nuk i konsuamuan deri në fund mjetet diplomatike në dispozicion të tyre, dhe se Millosheviqi nuk ishte kundër tyre. Sipas tij, Millosheviqi, ishte dakord me draftin e ofruar në atë konferencë, por nuk ishte dakord me një shtesë, që sipas tij ishte e papranueshme, dhe që u fut tinëzisht nga delegacioni i Britanisë së Madhe. Ai pretendon se mediatorët perëndimorë mbështetën propozimin shtesë të delegacionit britanik, të titulluar “Aneks Ushtarak”, i cili, sipas tij, çoi në refuzimin përfundimtar të delegacionit serb. Thelbi i propozimit, shkruan Gibbs, kishte të bënte me vendosjen e trupave të NATO-s jo vetëm në Kosovë, por edhe në territoret e Jugosllavisë së mbetur të asaj kohe. Ky propozim i mbrapshtë dhe i papranueshëm gjykon Gibbs, hodhi në erë tërë strukturën reale apo virtuale që ishte ndërtuar deri në këtë kohë. Kjo tezë nuk duket e besueshme dhe e mbështetur për disa arsye: *së pari*, sepse nuk gjenden dëshmi që të mbështesin versionin e pretenduar nga autori, se forcat e NATO-

2002).

⁴⁵ Wesley K. Clark, *Waging Modern War...*, f. 9; Sylë Ukshini, *Roli i politikës gjermane...*, f. 226-227.

⁴⁶ David Gibbs, “Was Kosovo the Good War?.. f.1-9.

s kërkuan të vendoseshin fillimisht në territorin e Kosovës dhe më vonë edhe në Jugosllavinë e mbetur. Vendosija e trupave paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara [në këtë rast ato të NATO-s] që do të vendoseshin në Kosovë ishte kusht i Grupit të Kontaktit, i bërë i ditur para fillimit të Konferencës së Rambujesë. Por, Serbia dhe presidenti Millosheviq, siç kemi përmendur më sipër, e kishin refuzuar atë që në fillim, përmes një rezolute të miratuar nga parlamenti i Serbisë, sepse u quajt si shkelje e sovranitetit të një vendi të pavarur. Si konkluzion, nuk mund të thuhet se kjo klauzolë u nxor nga “mëngët” në çastin e fundit, për t’u përfshirë padrejtësisht në aneksin ushtarak të Konferencës së Rambujesë, pas propozimit të britanikëve, por ajo ishte bërë e ditur më herët. Anëtarët e Grupit të Kontaktit me përjashtim të Ruisisë, e miratuan variantin e dërgimit në Kosovë të një trupe ndërkombëtare të udhëhequr nga NATO-ja⁴⁷, e cila do të garantonte zbatimin e marrëveshjes së arritur. Por, nëse Serbia nuk do ta pranonte marrëveshjen e Rambujesë, sulmet e NATO-s do t’i drejtoheshin edhe kundër Serbisë, e cila shihej me të drejtë si burim i krizës së Kosovës. *Së dyti*, nëse do të ekzistonte një kërkesë e tillë, ajo do të kishte gjetur vend në marrëveshjen e datës 10 qershor, të arritur ndërmjet NATO-s dhe qeverisë së Jugosllavisë së mbetur, por një gjë e tillë nuk gjendet. Duket se autori “ngatërron” konceptin e vendosjes së trupave në Kosovë me objektivat e sulmeve të NATO-s, të cilat do të përfshinin edhe Serbinë.

Me Konferencën e Rambujesë, Perëndimi konsumoi mjetet politike e diplomatike për arritjen e qëllimit, të cilat nuk u pranuan nga Millosheviqi, duke i hapur rrugën të vetmit mjet që mbetej, përdorimit të forcës, që do ta detyronin Millosheviqin të pranonte zgjidhjet e rekomanduara në tryezën e bisedimeve. Por Millosheviqi, siç treguan ngjarjet, nuk e lexoi mirë mesazhin e Konferencës së Rambujesë. Ai e konsideroi atë një bluf të vendeve perëndimore e SHBA. Milosheviqi i përmbahej arsytimit të tij se, Perëndimi thjesht po synonte të arrinte një marrëveshje në tavolinë, duke stimuluar një zgjidhje diplomatike, se sa të përdorte forcën, duke siguruar një pretekst për bombardim. Në fakt ai gaboi në llogaritë e tij, duke menduar se NATO nuk do të ndërhynte në Serbi e Kosovë pa miratimin e Këshillit të Sigurimit. “Sipas të gjitha gjasave, shkruan Wesley Clark, Millosheviu nuk hyri në procesin e Rambujesë me ndonjë qëllim për të negociuar seriozisht. Përkundrazi, në të gjitha gjasat ai e pa atë si momentin perfekt që i paraqitej për të pozicionuar veten për të shpallur operacionin ‘patkoi’(Potkova), si

⁴⁷K. Kaser, W. Petritch, R. Pichler, *Kosovo-Kosova...*, f. 326-327, cituar nga artikulli i autorit Sylë Ukshini, “Roli i politikës gjermane në Konferencën e Paqes në Rambuje”...*Studime historike*, nr. 1-2, 2016.

fushatë embrionale të spastrimit etnik me emër të koduar”.⁴⁸ *Së dyti*, Gibbs mendon se shqiptarët dhe sidomos UÇK, u viktimizuan tej mase në mënyrë të qëllimshme nga Perëndimi, për të justifikuar ndërhyrjen e tyre në Kosovë, ndërsa Serbia u anatemua në mënyrë jo proporcionale. Sipas tij, UÇK-ja ishte dhe mbeti forcë terroriste, ndërsa spastrimi etnik, arsyeton ai, “ndonëse qe më i madh tek shqiptarët e Kosovës”, përfshiu edhe popullsinë serbe të Kosovës. Shifrat e tij për numrin e serbëve të zhvendosur nga lufta janë tejet të fryra dhe të pambështetura nga burimet të tjera. Raporti i shpërnguljes së serbëve nga Kosova ishte jo proporcional krahasuar me zhvendosjen “biblike” të popullsisë shqiptare të Kosovës. “Fajësia” e UÇK-së si forcë “terroriste” i përkiste periudhës së fillimit të aksioneve të saj, por pas muajit shkurt 1998 ajo nuk u konsiderua më si e tillë nga politika amerikane e perëndimore në përgjithësi.

Siç, tregoi koha, e vetmja rrugë për të reaguar ndaj pushtimit serb të Kosovës për UÇK-në, mbetej rezistenca e armatosur. Pa luftën e UÇK-së do të vazhdonte gjendja e pushtimit të Kosovës, ndërsa komunitetit ndërkombëtar do ta kishte të vështirë të angazhohej në zgjidhjen serioze të krizës në këtë rajon të Ballkanit Perëndimor. Ata që kishin humbur deri në atë kohë ishin shqiptarët, ndërkohë që Serbia kishte arritur maksimumin e mundshëm të saj në Kosovë, pas suprimimit të autonomisë së saj në vitin 1989-1990. *Së treti*, Gibbs mbron idenë se sulmet e NATO-s nuk sollën rezultatin e pretenduar - parandalimin e dhunës serbe dhe spastrimin etnik të popullsisë shqiptare, por të kundërtën e asaj që u pretendua. Sipas tij, fenomeni i spastrimit etnik mori përmasa më të mëdha pas sulmeve të NATO-s, ndërsa numri i viktimave u shtua. Zhvendosja e detyruar e qindra mijërave shqiptarëve etnikë nga Kosova, si rezultat i përdorimit të forcës nga Millosheviqi, nuk u arrit të ndalej gjatë kohës që NATO bombardonte, por duhet nënvizuar se, pa aksionet e saj ushtarake nuk do të ishte bërë e mundur që shumica dërmuese e refugjatëve të riktheheshin në Kosovë. Në këtë kuptim ato ishin të suksesshme dhe ia arritën qëllimit. Duhet theksuar, se “spastrimi etnik” i shqiptarëve nga Kosova nuk filloi me sulmet e NATO-s, por më herët. Perëndimi do të kishte dashur që t’i jepte fund luftës me bisedime, por kjo rrugë nuk dha fryte. Askush nuk do të donte të harxhonte miliarda dollarë shpenzime dhe jetë të humbura, nëse rruga paqësore do të kishte funksionuar. Anëtarët e NATO-s nuk e patën të lehtë marrjen e vendimit për sulmin ndaj Serbisë, por sjellja intransigjente e udhëheqësve të saj, brutaliteti i shfaqur në

⁴⁸ Wesley K. Clark, *Waging Modern War:...*, f. 9.

Kosovë dhe e shkuara e afërt e keqe e ngjarjeve të Bosnjës i bindën ata për përdorimin e forcës.

Ndërhyrja ushtarake e NATO-s ishte akt i motivuar, pavarësisht nga rezervat e shprehura nga disa shtete dhe disa specialistë të së drejtës ndërkombëtare. Ndërhyrja e NATO-s nuk dhunoi ligjin ndërkombëtar, pavarësisht se nuk u sigurua autorizimi i Këshillit të Sigurimit, për shkak të kundërshtimit të parashikuar të dy anëtarëve të përhershëm të tij, Ruisë e të Kinës. Por, duhet të përmendim nga ana tjetër se Këshilli i Sigurimit nuk ia mbylli dyert ndërhyrjes së NATO-s, sepse ai nuk e miratoi projekt-rezolutën e propozuar nga Rusia më 26 mars 1999, e cila kërkonte ta shpallte të jashtëligjshme ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë e Serbi. Projekt-rezoluta e paraqitur nga Rusia dhe e mbështetur edhe nga Kina e Namibia humbi gjatë votimit me rezultatin e përgjithshëm 12 me 3.⁴⁹

Shumica dërmuese e studiuesve dhe e politikanëve kanë argumentuar e mbështetur idenë e legjitimitetit të bombardimeve të NATO-s mbi RFJ. Legjitimiteti i saj u mbështet tek teoria e "Ndërhyrjeve për arsye humanitare", tek Karta e Kombeve të Bashkuara për liritë dhe të drejtat e njeriut, dhe tek Tre Rezolutat e miratuara nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, të pazbatuara nga Jugosllavia dhe tek vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Përsiatjet teorike të disa studiuesve për mosgjatjen zbatim të kësaj teorie në vende me situata të ngjashme me atë të Kosovës, duke se janë probleme që kërkojnë studime të mëtejshme. Në planin teorik shumë historianë dhe studiues të marrëdhënieve ndërkombëtare e konsiderojnë të motivuar fushatën ajrore të NATO-s në Kosovë e Serbi, duke u mbështetur tek "teoria humanitare", e cila nënkupton dënimin e fajtorit për fajin e kryer dhe parandalimin e tij, nëse është e mundur.⁵⁰ Pra agresori, në rastin konkret Serbia, u dënua për një faj të kryer dhe jo të supozuar. Në Kosovë ndodhën krime lufte të dënueshme nga ligjet ndërkombëtare dhe spastrime etnike në shkallë të gjerë, gjë që e justifikuan ndërhyrjen e NATO-s për të parandaluar këtë proces e për të rikthyer në shtëpitë e tyre qindra mijëra shqiptarë të shpërngulur me dhunë. Nga shkurti 1998 deri në mars 1999, si rezultat i konfliktit me forcat serbe, sipas një burimi, u shpërngulën mbi 400 000 njerëz nga shtëpitë e tyre dhe u vranë mbi 2 500 vetë.⁵¹ Sipas një raporti të

⁴⁹ Kosovo Conflict Chronology: September 1998 - March 1999, April 6, 1999 RL30127.

⁵⁰ Clive Staple Lewis, "The Humanitarian Theory of Punishment", AMCAP Journal, Vol. 13, No.1, 1987, f. 147-153.

⁵¹ Julie Kim, "Kosovo and U.S. Policy: Background to Independence", CRS Report for Congress, Congressional Research Service, Prepared by Committees of Congress. Order Code RL31053.

Departamentit të Shtetit të dhjetorit 1999, numri total i refugjatëve dhe personave të shpërngulur nga Kosova arrinte në 1,5 milion vetë, ose mbi 90% të popullsisë etnike të saj. Gjithashtu ishin vrarë rreth 10 000 shqiptarë dhe ishin torturuar, abuzuar e përdhunuar mijëra të tjerë.⁵²

Serbia nuk e njohu pavarësinë e Kosovës, por përkundrazi më 15 gusht 2008 ajo i kërkoi zyrtarisht Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë që të shprehej, “nëse deklarata e pavarësisë së Kosovës përbente dhunim të legjislacionit ndërkombëtar”? Përgjigja e këtij Institucioni ishte refuzuese. Vendimi për njohjen e Pavarësisë së Kosovës, i marrë nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë - organ i Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, më 22 korrik 2010 mori 10 vota pro dhe 4 kundër. Kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, Hisashi Owada, deklaroi: “Shpallja e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, nuk ka shkelur të drejtën ndërkombëtare, as rezolutën 1244 dhe as Kornizën Kushtetuese të UNMIK-t”.⁵³ Sidoqoftë, përdorimi i forcave të NATO-s pa miratimin e Këshillit të Sigurimit përbente një precedent deri në atë kohë. Fushata e NATO-s në Kosovë ishte një sfidë për vetë Aleancën e Atlantikut të Veriut, jo thjesht në aspektin teorik, por edhe për të dëshmuar efektivitetin e sulmeve ajrore të saj. Ngjarjet që ndodhën në Kosovë në vitet 1998-1999 do të jenë temë me interes edhe për të ardhmen, për shkak se ajo që ndodhi në Kosovë nuk ishte një gjë e zakonshme.

Siç ka treguar koha, procesi i njohjes së Kosovës nga Serbia, i pranimit të saj në Kombet e Bashkuara dhe i integritimit në Bashkimin Evropian është një rrugë e gjatë dhe me pengesa. SHBA-ja ishte ndër të parat shtete që e njohu shpalljen e pavarësisë së Kosovës, ndonëse rolin drejtues në shtetin e ri pas vitit 1999 nuk e luajti ajo, por Bashkimi Evropian. Prania amerikane në Kosovë ndjehet gjithandej, në sferën politike, ushtarake, ligjore e ekonomike dhe vazhdon të mbetet një faktor kyç për sigurinë e saj.

⁵² CRS Issue Brief for Congress, Steven Woehrel and Julie Kim, Foreign Affairs, Defense, and Trade Division, “Kosovo and U.S. Policy”, Updated June 22, 2001, Order Code IB98041.

⁵³ Wikipedia, aksesuar më 21 nëntor 2023.

Hamit KABA

SUMMARY

THE JUSTIFICATION FOR NATO'S INTERVENTION IN KOSOVO IN THE CONTEXT OF INTERNATIONAL RELATIONS

The atrocities committed in Kosovo, including war crimes and mass displacement of Albanian people, warranted intervention from NATO in order to prevent further injustices and allow hundreds of thousands of forcibly displaced individuals to return to their homes. Despite the occasional unintentional harm to civilians, NATO strictly followed orders to target only military objectives. However, the decision to deploy NATO forces without the approval of the Security Council set a precedent at the time. The campaign in Kosovo became a true test for the Alliance, not only in theory but also in proving the success of their air strikes.

The focus of NATO's military efforts was strictly on strategic targets, with minimal collateral damage to civilians, although there were isolated incidents. The overall objective of NATO and the United States was to prevent a situation like that in Bosnia, by securing the safe repatriation of innocent civilians in Kosovo. The use of cutting-edge technology and precise execution enabled the Alliance's forces to suffer only two casualties: an Apache helicopter that unfortunately crashed in Albania and an F-117 Nighthawk that went down in Belgrade. The tumultuous events that took place in Kosovo between 1998 and 1999 continue to captivate the minds of scholars and historians, as they represent a unique and unprecedented departure from accepted legal and theoretical norms. Despite the passage of time, the journey towards Kosovo's recognition and eventual acceptance into the United Nations and European Union has been far from smooth, beset by challenges and obstacles. However, one undeniable truth remains: the story of Kosovo is one of victory for the Albanian people and the international community, but also of defeat for the Serbs.